



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Shkencat Politike (2012/2013)**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Titulli	I diplomuar në shkenca politike
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-672/2
Data akreditimit	22.06.2012

Përshkrimi i programit

Programi i shkencave politike synon të njoftojë studentët me parimet themelore të politikës, organizimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, po ashtu edhe tautoriteteve politike, mendimit politik dhe pyetjeve teorike të qeverisjes. Përshkruan dhe identifikon degët e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; bashkëveprimin e tyre në shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale.

Qëllimet kryesore të programit janë:

- Studentët të fitojnë njohuri teorike dhe të kuptojnë rëndësinë e proceseve politike nëpërmjet qasjes politike krahasuese.
- T'i aftësojë të marrin pjesë në nivele të ndryshme të sistemit qeveritar dhe jetës publike dhe si analistë politikë të japin pikëpamjet e tyre lidhur me problemet politike.
- T'i përgatisë studentët për vlerësimin e tendencave politike në shoqërinë dhe shtetin, të vlerësojnë ndikimin e tyre në proceset evropintegruese në vend dhe rajon.
- T'i aftësojë studentët për të identifikuar nevojat e grupeve të interesit dhe institucioneve shtetërore në kuadër të procesit politikë.
- Të mund të marrin iniciativë për identifikimin dhe adresimin e nevojave për mësim të institucioneve shtetërore dhe administratës publike.

Karriera

Studimet e Shkencave Politike mundësojnë plotësimin e nevojave arsimore në përkrahjen e studentëve në fillimin e karrierës së tyre profesionale në agjencitë qeveritare në nivel qendror dhe lokal, komunat, institucionet publike, partitë politike, organizatat jofitimprurëse, universitetet dhe ndërmarrjet.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të parimeve themelore të politikës, organizimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare dhe autoriteteve politike, mendimit politik dhe pyetjeve teorike për udhëheqjen.
- Ka njohuri të degëve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe të bashkëveprimit të tyre me sundimin e së

drejtës dhe demokracisë funksionale.

- Ka njohuri teorike dhe kuptim të rëndësishëm të proceseve politike përmes qasjes krahasuese politike.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Ka mundësi të punojë në organizime politike të institucioneve qeveritare dhe ato joqeveritare si dhe të sigurojë analizë për proceset e ndryshme politike.
- Mund të marrë pjesë në nivele të ndryshme të sistemit qeveritar dhe jetës publike, si analistë politik duke dhënë analiza profesionale në favor të zgjidhjes së problemeve politike.
- Është në gjendje të realizojë një anketë publike dhe të implementojë metodologji përkatëse.
- Është në gjendje të demonstrojë aftësinë për të lobuar, të posedojë dhe negociojë me më shumë aktorë me ndikim politik në shoqëri.
- Mund të aplikojë njohuri teorike, të realizojë hulumtime për të zgjidhur fenomenet shoqërore dhe të zhvillojë karrierë në fushën akademike.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ka aftësi për të menduar në mënyrë kritike dhe aktivisht të përfshihet në çështjet aktuale politike në nivel qendror dhe lokal.
- Të bëjë dallimin e fenomeneve të ndryshme që lidhen me kulturën politike të një komuniteti.
- Në mënyrë kritike krahason trendet politike në shoqëri dhe shtet dhe vlerësojnë ndikimin e tyre në proceset integruese të vendit.

Aftësitë e komunikimit

- Është në gjendje të marrë pjesë në debate politike, ndërmjetësim dhe negociata, duke siguruar analizë të argumentuar të diskursit politik.
- Aftësi koherente për të shkruar ngjarje dhe fjalime politike.
- Tregon aftësi për komunikim profesional me më shumë aktorë në frymën e ekipit dhe qasje gjithëpërfshirëse.

Aftësitë e të mësuarit

- Mund të definojë dhe vërtetojë rolin e politikës në shoqëri të bazuar në dije.
- Mund të ndërmarrë iniciativë për identifikimin e interesave të grupeve dhe institucioneve shtetërore në kuadër të procesit politik.
- Ka shkathtësi për të zbatuar të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vetëdukim në fushën e shkencave politike.
- Aftësi për të trajnuar qytetarët për sistemin politik dhe shoqërinë demokratike.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Fillet e të drejtës**
- [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat politike**
- [6.0 SETK] **Parimet e sociologjisë**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Angleze1**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Shqipe/Maqedonase 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 1**

Semestri 2

- [6.0 SETK] **Mendimi bashkëkohor politik**
- [6.0 SETK] **Hyrje në politikën ekonomike**
- [6.0 SETK] **Psikologjia sociale**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Angleze 2**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuha Shqipe/Maqedonase 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 2**

Semestri 3

- [6.0 SETK] **Bazat e statistikës**
- [6.0 SETK] **Metodat hulumtuese në shkencat politike**
- [6.0 SETK] **E drejta kushtetuese**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 3**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuga Angleze për qëllime specifike 1**

Semestri 4

- [6.0 SETK] **Partitë politike dhe modelet zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Marrëdhëniet ndërkombëtare**
- [6.0 SETK] **Menaxhimi politik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore nga Gjuga Angleze për qëllime specifike 2/ ose Lëndë zgjedhore 4/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 4/2**

Semestri 5

- [6.0 SETK] **Financat Publike**
- [6.0 SETK] **Hyrje në politikat publike**
- [6.0 SETK] **E drejta ndërkombëtare publike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 5/1/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 5/2/1**

Semestri 6

- [6.0 SETK] **Sistemet politike krahasuese**
- [6.0 SETK] **Politika e marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike**
- [6.0 SETK] **Globalizimi si fenomen i shoqërive bashkëkohore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 6/1/1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 6/2/1**

Description of courses

Lëndë obligative

• Fillet e të drejtës

Fillet e të drejtës përdor njohuritë, konceptet dhe kategoritë themelore nga disiplinat e tjera të së drejtës dhe ka për detyrë t'u japë atyre njohuri themelore, të përgjithshme dhe hyrëse lidhur me shtetin dhe të drejtën.

• Hyrje në shkencat politike

Nëpërmes kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri për kategoritë themelore, konceptet dhe definicionet, të cilat do t'u ndihmojnë për të kuptuar, studiuar dhe në mënyrë kritike t'i qasen politikës dhe shoqërisë bashkëkohore. Më tutje duhet të: * Të rrisin kulturën dhe vetëdijen e tyre politike me ndihmën e teksteve nga autorët klasikë dhe ata bashkëkohorë si dhe analistëve politikë. * Të rrisin njohuritë dhe kapacitetet e tyre për të studiuar etikën politike evropiane. * Studentët të përsosin shkrimin e tyre, mendimin dhe shprehjen lidhur me politikën. Nëpërmes ligjëratave studentët duhet të marrin përgjigje në disa pyetje themelore, si për shembull: Çka është politika dhe pse ajo është aq e rëndësishme për jetën tonë dhe të shoqërisë? Si është zhvilluar njeriu si një entitet politik? Çka e karakterizon shoqërinë bashkëkohore demokratike? Cilat janë karakteristikat e shoqërisë së Maqedonisë si shoqëri politike? Çka është politika? A është ajo pjesë integrale e njeriut? Pse dhe si e mësojmë politikën?

• Parimet e sociologjisë

Lënda "Parimet e sociologjisë" ka për qëllim të përgatisë studentët me njohuri të përgjithshme rreth fenomeneve sociale si dhe me njohuri të veçanta dhe specifike rreth proceseve dhe fenomeneve shoqërore me të cilat ata përballen dhe do të përballen në të ardhmen si qytetarë dhe akademikë.

• Mendimi bashkëkohor politik

Lënda është dizajnuar në atë mënyrë që studentëve t'u sigurojë njohuri themelore dhe aftësi për mendimin

bashkëkohor politik në botë dhe në vend. Kjo do të përfshijë mendimtarët bashkëkohorë dhe klasikë si që janë: Makijaveli, Xhon Lok, Raus, Nusbaum, Eduard Said, Amin Maluf etj. Traditat liberale, identitetet, shoqëria e lirë, feminizmi, multikulturalizmi janë konceptet kryesore të teorisë politike dhe praktikës shoqërore. Paradigmat e reja shoqërore, jeta politike në institucionet do të pëfshijnë edhe elemente filozofike, sociologjike madje edhe juridike dhe mbizotërimin normal të momentit politik. Kjo lëndë do t'u mundësojë studentëve të përceptojnë dhe të interpretojnë dukuritë politike dhe shoqërore, aktivisht të marrin pjesë në jetën politike dhe zhvillimin e mendimit politik bashkëkohor.

- **Hyrje në politikën ekonomike**

Ekonomia politike shqyrton rolin e proceseve ekonomike në formësimin e shoqërisë dhe kulturës. Ekonomia politike e bën një analizë të përgjithshme politike, sociale, kulturore, ekologjike dhe përfshin bashkëveprimin e tyre me proceset ekonomike dhe zhvillimore. Pyetjet themelore që kjo lëndë përfshin janë: si ndikojnë institucionet politike në rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik. Si ndikojnë kushtet ekonomike në procesin e vendimmarrjes dhe te politikatat.

- **Psikologjia sociale**

Temat e diskutimit përfshijnë: përceptimin e personalitetit, marrëveshjet, formimin e mendimeve, vlerësimin dhe ndryshimet, paragjykimet, agresivitetin, të mësuarit social, dinamikën e grupit, psikologjinë sociale dhe aplikimin shoqëror, ligjor dhe organizativ.

- **Bazat e statistikës**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore të metodave parësore statistikore dhe zbatimin e tyre me qëllim që të ndjekin literaturën profesionale, që të mund në mënyrë koncize të paraqiten rezultatet dhe përfundimet e hulumtimit të bërë. Aspektet kryesore të studimit të kësaj lënde janë: përcaktimi i disiplinave, lidhja e të dhënave, analiza statistikore, zbatimi i metodave statistikore në fushën e shkencave humane, demonstrimi i të dhënave statistikore dhe lidhshmëria e statistikës me shkencat tjera.

- **Metodat hulumtuese në shkencat politike**

Kjo lëndë u mundëson studentëve të njihen me metodat hulumtuese shkencore në sferat shoqërore dhe dukuritë politike. Studentët do të fitojnë njohuri nga aspekti teorik dhe praktik, për metodat kërkimore dhe shkencore dhe rëndësinë e tyre për shkencën, si dhe për individët në shoqëri. Përmbajtja e lëndës: hulumtime teorike dhe empirike; proporcionet e metodologjisë dhe teorisë së njohjes; njohuritë shkencore dhe struktura e tyre; roli dhe funksioni i projekteve kërkimore shkencore; monitorimi; pyetësori; klasifikimi; interpretimi i materialit të mbledhur fotografik etj.

- **E drejta kushtetuese**

Studentët përfitojnë njohuri teorike dhe praktike nga e drejta kushtetuese si degë themelore e së drejtës, Kushtetuta si akti më i lartë juridik dhe politik i shtetit si dhe nga kushtetushmëria dhe ligjshmëria si parime bazë të shtetit juridik.

- **Partitë politike dhe modelet zgjedhore**

Partitë politike janë subjekt themelor i jetës demokratike në çdo shoqëri bashkëkohore. Modelet zgjedhore janë komponent më i rëndësishëm i çdo sistemi politik, kështu që kjo lëndë ka rëndësi të veçantë për të fituar njohuri të cilat studentëve do t'u mundësojë të pajisen me informacione të duhura për funksionimin e shoqërisë pluraliste. Nëpërmjet të kësaj lënde studentët do të informohen më për së afërmi me thelbin e partive politike dhe me ndikimin e tyre në sistemet politike bashkëkohore, me marrëdhëniet në mes të partive politike dhe demokracisë bashkëkohore si dhe për shumë faktorë të tjerë të cilët e përcaktojnë jetën shoqëro-politike bashkëkohore.

- **Marrëdhëniet ndërkombëtare**

Kjo lëndë njofton studentët me komponentët teorikë në marrëdhëniet ndërkombëtare, idetë dhe debatet kryesore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare e sidomos në konceptet themelore, aktorët në marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën e jashtme, fuqinë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ligjëratat do të fokusohen në politikën ekonomike ndërkombëtare dhe politikën e mirëqenies globale, problemet ekzistuese dhe të ardhshme në sistemin ndërkombëtar duke përfshirë edhe konfliktet e armatosura, ekonominë, demografinë dhe mjedisin jetësor.

- **Menaxhimi politik**

* Përvetësimi i njohurive themelore të termeve politike dhe menaxhment * Të njihen me mjetet themelore dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me dallimin e proceseve politike sipas kriteriumeve të ndryshme. * Përfitimi i njohurive adekuate për përgatitje të anketës dhe punës në terren. * Aplikimi i njohurive të fituara nga lëndët tjera dhe ndërtimi i

një metodologjie të posaçme për përpunimin e eseve-punimeve seminarike. * Të analizohen proceset zgjedhore dhe mënyra e realizimit. * Të përgatitet fjalim politik dhe të simulohet një ngjarje politike. * Aftësi për pjesëmarrje aktive në debat të organizuar nga Unioni i studentëve. * Aftësi për të përgatitur dhe për të marrë pjesë në projekte hulumtuese si dhe prezantim të rezultateve të kërkimit shkencor. * Të përcaktojë mënyra të ndryshme në përdorimin e burimeve shkencore, të mësojë e të lexojë selektivisht dhe të analizojë proceset politike në mënyrë krahasuese.

• **Financat Publike**

* Studentëve u sigurohet njohuri lidhur me financat publike, si një nga rolet kryesore të politikave makroekonomike dhe instrumenteve themelore për funksionimin e një ekonomie kombëtare si një tërësi dhe si një nënsistem i një sistemi ekonomik të vendit. * Njoftohen me njohuri për të mirat publike dhe shpenzimet, alokimin dhe rialokimin e të hyrave, aspektet krahasuese të financave publike në vendet e zhvilluara dhe atyre të tranzicionit, specifikat e sistemeve fiskale në Maqedoni, trendet dhe sfidat e tyre, decentralizimi fiskal etj. * Pajisen me njohuri profesionale lidhur me buxhetin dhe fondet jashtëbuxhetore si instrumente kryesore të politikës fiskale, të procedurave rreth përgatitjes, përpunimit, përmbledhjes, miratimit, krahasimit dhe kontrollit të buxhetit, si dhe teknikave të buxhetit si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. * Krijimi i një pasqyre të qartë për studentët lidhur me funksionimin e një sistemi fiskal të dhënë, duke u dhënë pikat e referimit për sa u përket teorive të ndryshme fiskale me të cilat do të mund realizojnë ndryshimet krahasuese dhe të gjejnë pikat e përbashkëta të funksionimit të këtyre sistemeve në vendet e ndryshme. * Njohja informative e studentëve me treguesit kryesorë të politikës fiskale në RM, krijimi i një baze reale e të dhënave në aspekt të trendeve fiskale afatgjata në RM duke stimuluar studentët të bëjnë punime seminarike dhe ese të pavarura në fushën fiskale.

• **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, evaluimin dhe zhvillimin e tyre. Menaxhimi i politikave publike është një disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

• **E drejta ndërkombëtare publike**

Kjë lëndë është e dizajnuar që t'i njoftojë studentët me konceptet themelore dhe problemet e së drejtës ndërkombëtare dhe rregullimin ndërkombëtar juridik. Lënda siguron njohuri për natyrën, strukturën dhe funksionin e sistemit juridik ndërkombëtar, ndarjen e së drejtës ndërkombëtare, parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare, aktorët në të drejtën ndërkombëtare, burimet e së drejtës ndërkombëtare, rregullimin e marrëdhënieve të shteteve, si dhe trajtimin e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar.

• **Sistemet politike krahasuese**

Nocioni i politikës dhe sistemit politik, sistemet politike dhe disiplinat e tjera shkencore të ndërlidhura, aspekti historik i zhvillimit të sistemeve politike, sistemet politike në mendimin politik antik, sistemet politike në mendimin politik bashkëkohor, klasifikimi i sistemeve politike, sistemet politike dhe ideologjia politike, sistemet politike dhe demokracia, sistemet politike dhe shteti, sistemet politike dhe globalizimi, sistemet politike të shteteve perëndimore, sistemet politike të vendeve postkomuniste, sistemet politike të vendeve në zhvillim.

• **Politika e marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike**

Ekonomia politike ndërkombëtare ka për qëllim ta studiojë marrëdhënien në mes sistemeve ndërkombëtare politike dhe ekonomike. Kjo lëndë bën analizë të përgjithshme të trendeve tregtare ndërkombëtare, rolin e politikës monetare, të menaxhimit politik dhe ndikimin e tyre në proceset ekonomike dhe zhvillim. Pyetjet bazë për të cilat kjo lëndë angazhohet është që të jape një qasje të qartë për atë pse disa shtete stagnojnë në zhvillimin e tyre dhe pse disa zhvillohen shumë më shpejt. Gjithashtu i kushton vëmendje angazhimit institucional dhe rëndësisë së tyre në zhvillimin e shoqërive.

• **Globalizimi si fenomen i shoqërive bashkëkohore**

Objektivat e programit të lëndës: - Të kenë një kuptim të thellë konceptual për globalizimin si fenomen që rrafshon botën (Fridman); - Të kenë një vizion për veten dhe shoqërinë në kushtet e globalizimit; - Aftësi për të debatuar globalizimin në mënyrë inteligjente dhe në dimensione të ndryshme: ekonomik, politik, kulturor, socio-hapësinor; - Të aftë për të identifikuar sfondin e globalizimit dhe reflekset problematike (p.sh antiglobalizimin); - Të gatshëm për të krahasuar perspektiva të ndryshme të globalizimit dhe ndikimet e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar; - Mundësi për të zhvilluar një studim të strukturuar të "produktit" ose (epi) fenomenit të globalizimit.

Lëndë zgjedhore

- **Institucionet dhe politikat e UE-së**

Kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me natyrën komplekse të fenomeneve që përbëjnë integrimin evropian, institucionet dhe politikat. Pjesa e parë e këtij moduli mbulon zhvillimin e institucioneve, procesin e sjelljes së vendimeve dhe rolin e aktorëve kryesorë, ndërsa pjesa e dytë mbulon politikat e BE-së. Gjithashtu, kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me interpretimet kryesore teorike dhe zhvillimin e BE-së, si dhe të marrë në konsideratë sfidat aktuale dhe të ardhshme me të cilat përballet BE në kuadër të institucioneve dhe politikave të saja.

- **Etika në politikë**

Qëllimet e planprogramit të lëndës (kompetencat): * Ka njohuri dhe kupton semantikën dhe konceptet e moralit të etikës, standardet e sjelljes, arsësimin moral dhe filozofinë morale. * Zhvillon qëndrim për pozitën e moralit në jetën profesionale. * Formon qëndrime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën publike dhe ate shtetërore. * Aftësi për t'u ballafaquar me situata problematike etike. * Ekziston ndjenjë e karakterit të nevojshëm në profesionin e administratorit. * Njohje me literaturë për etikën në sferën a administrimit publik. * Gatshmëri për të përdorur mjete të komunikimit dhe të respektojë standardet etike në punën në institucionet shtetërore dhe aktorëve publikë.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrimi publik përfraçëson një fushë me interes të veçantë për shkencën. Me lëndën Hyrje në administrimin publik studentët marrin njohuri mbi konceptet themelore të administrimit publik. Theks i veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të administrimit publik, si dhe reformave në këtë fushë në vendin tonë. Studentët do të kenë mundësi të njihen me këtë fushë dhe në mënyrë kritike të analizojnë zhvillimin dhe dukuritë në administrimin publik. Pasiqë kjo fushë është subjekt i ndryshimeve konstante, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet teorive të reja si dhe teorive klasike të administrimit publik. Subjekti i hulumtimit përbëhet nga: termet dhe njohuritë themelore lidhur me parimet dhe institucionet e administrimit publik; roli dhe rëndësia e administrimit publik në shoqërinë e organizuar; gjeneza dhe zhvillimi historik i administrimit publik; struktura organizative e administrimit publik; funksionimi i institucioneve të administratës publike; nëpunësit civilë; kontrolli dhe përgjegjësia e administrimit publik; komunikimi në administrimin publik; administrimi publik si shërbim për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut, etj.

- **Kultura politike**

Termi kulturë politike në vete i përfshin normat, vlerat dhe simbolet të cilat e ndihmojnë legjitimimin e sistemit të fuqisë politike. Në kuadër të kësaj fraze nënkuptohet edhe tradita politike e një kombi, vetitë të cilat u japin domethënie institucioneve politike, rregullat jozyrtare të cilat i japin ngjyrë jetës politike, qëllimet të cilat i përmend ideologjia politike dominante. Kulturës politike i përshkruhen shumë veti të tjera, duke filluar nga paragjykimet politike, metodat politike, fryma politike si dhe deri tek ajo që thirret legale ose jolegale. Edhe pse term i ri, përdorimi modern i së cilës daton që nga periudha e Luftës së dytë botërore, ai është shumë i rëndësishëm në kuadër të politikës, para së gjithash për ballafaqimin e besimit të qytetarëve përkundër skandaleve, apokalipsave, rënieve dhe katastrofave politike, për kuptimin e kulturave politike të vërteta dhe të imponuara.

- **Hyrje në ekonomi**

Lënda është dizajnuar me qëllim që studentët të njihen me mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes. Megjithatë, vëmendje do t'i kushtohet funksionit të financimit, marketingut dhe organizatimit të ndërmarrjes. Përveç kësaj, analizohet ndikimi i ndërmarrjes në rrethinën ku ajo vepron.

- **Zgjidhja paqësore e konflikteve**

* Njohuri të përparuara për qasje shkencore për zgjidhjen paqësore të konfliktit me anë të metodave bashkëkohore. * Të njihen me mjetet dhe aktivitetet lidhur me parandalimin e konflikteve, ku në kohë do të jetë në gjendje të zbulojë burimet e mundëshme. * Përfitim të njohurive adekuate për pjesëmarrje aktive në proceset paqësore, si dhe përgatitje të strategjisë dhe taktikës për negociatave të suksesshme në procesin e negociatave. * Aplikim të një metodologjie të veçantë të strategjisë dhe taktikës në procesin e negociatave. * Të analizohen aktivitetet dhe veprimet e aktorëve të ndryshëm në konflikt. * Të identifikojë dhe analizojë rolin e organizatave ndërkombëtare në zgjidhjen paqësore të konflikteve. * Aftësi për pjesëmarrje aktive në procesin e bisedimeve dhe ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. * Aftësi për të përgatitur dhe marrë pjesë në projektet hulumtuese si dhe prezentimin e rezultateve të hulumtimit kërkimor-shkencor.

- **Religjioni dhe politika**

Qëllimet e lëndës (kompetencat): * Kanë njohuri dhe i kuptojnë dimensionet e ndryshme të religjionit dhe jetës politike. * E analizojnë dhe mendojnë në mënyrë kritike për relacionin në mes religjionit dhe politikës. * Të aftë që t'i shprehin analizat e tyre përmes shkrimeve dhe komunikimit verbal. * Të aftë të marrin pjesë në ndërtimin korizës shoqërore për pluralizmin religjioz-fetar, për krijimin e klimës pozitive në mes personaliteteve fetare, shtetërore dhe politike. * Të aftë të mësojnë nga literatura tjetër për ndikimin politik të religjionit dhe vice versa.

- **Mediat dhe marketingu politik**

Pas mbarimit të lëndës studentët do të: * Kuptojnë mjetet për komunikim masiv, teoritë, efektet e mediave dhe rolin në shoqëri. * Do të mundën t'i përshkruajnë dhe ta identifikojnë rolin e mediave dhe teknologjive informative në jetën politike. * Do t'i kuptojnë porosinë e mediave, teknologjitë, publikun dhe rezultatet që të përmirësohet kapaciteti profesional për ata që punojnë me ose në media. * Do të jenë në gjendje që të mendojnë në mënyrë kritike, të japin komente, të bëjnë krahasim dhe t'i bëjnë analizë të paraqitjes së politikës në media. * Kanë njohuri teorike dhe themelore praktike të cilat do t'u mundësojnë angazhim profesional në krijimin e fushatave të marketingut, operacionalizimin dhe realizimin e fushatave. * Mund të marrin pjesë në aktivitete në sferën e marrëdhënieve publike (përdorimin e literaturës profesionale dhe rezultate nga hulumtimet empirike, mbledhje, procesim dhe përdorim të të dhënave relevante, definimin dhe elaborimin e problemeve konkrete, prezantim të rezultateve të veta etj.)

- **Sistemi politik i RM-së**

Lënda sistemi politik i RM-së ka për qëllim t'u ofrojë studentëve në studimet deridiplomike në Fakultetin e administrimit publik dhe Shkencave politike njohuri të përgjithshme dhe të veçanta rreth funksionimit të sistemit politik në Republikën e Maqedonisë në tërësi dhe funksionimin e institucioneve të veçanta të sistemit politik të Republikës së Maqedonisë.

- **Sistemet e vetëqeverisjes lokale**

Studentët e Fakultetit të administrimit publik dhe Shkencave politike duhet të zotërojnë aftësi themelore madje edhe më të thella lidhur me organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Po ashtu edhe kenë njoftim për marrëdhëniet e pushtetit lokal dhe qendror dhe parimet bazë të vetëqeverisjes lokale në shtetet me vetëqeverisje lokale tradicionale, në shtetet e Evropës juglindore dhe në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi i studimit të kësaj lënde është studentët të jenë të përgatitur në nivelin e duhur që të mund të kryejnë obligimet tërësisht dhe me përgjegjësi.

- **Shteti social dhe politika**

Politika e shtetit social ka qëllimet kryesore si vijon: * U mundëson studentëve të analizojnë faktorët institucionalë dhe politikë të cilët kanë formë të zhvillimit të shtetit social (në Britaninë e Madhe dhe shtetet tjera) në të kaluarën dhe gjithë ai formim në të tashmen; * U mundëson studentëve të kuptojnë se si funksionon shteti social, siç është e dhënë, si paguhet dhe cilat janë përfitimet nga ajo; * U mundëson studentëve të identifikojnë argumentet politike për dhe kundër ndodhjeve të fundit në fushat kyçe të politikës (siç janë politika shëndetësore, punësimi dhe politika sociale, politika e sigurimit, politika e strehimit dhe politika e së drejtës penale); * Të mundësohet zhvillim i aftësive për të mësuar lëndën duke përfshirë interpretimin e të dhënave.

- **Antropologjia politike**

Përmbajtja e planprogramit të lëndës: Në mesin e studimit të antropologjisë politike janë natyra e njeriut, bashkësitë njerëzore veçanërisht ato politike, sistemet politike paraindustriale dhe ato bashkëkohore, organizimi politik, shteti, fuqia, pushteti, autoriteti, konfliktet veçanërisht ato më dramatike dhe më të rrezikshmet të cilat bazohen në forcë dhe dhunë, mitet politike, rritualët dhe simbolet. Ligjëratat sigurojnë informacion dhe kategorizim të antropologjisë politike si një disiplinë pak e zhvilluar te ne .

- **Rinia dhe politika**

Kjo lëndë ofron një perspektivë bashkëkohore socio-politike të politikës dhe rinisë si një grup më thelbësor i shoqërisë. Rinia e sotme, përveç që është temë e analizave të shumta shkencore ajo në të vërtetë është para sfidave të mëdha lokale dhe globale lidhur me karrierën dhe ekzistencën e saj. Të rinjtë janë pjesë përbërëse të një grupi ku janë lindur dhe jetojnë. Në të njëjtën kohë ne jemi pjesë përbërëse e një strukture të ndërlikuar të organizimit e cila ka problemet e veta sidomos me institucionet politike. Lënda do të përmbledhë të gjitha dilemat teorike dhe praktike në sferën e realizimit të gjeneratës rinore me jetën politike dhe institucionet e shoqërisë demokratike. Procesi i socializimit të gjeneratës së re , pjesëmarrja në jetën politike dhe publike,...Frojdi e quan Super ego ndërsa Herbert Mid komunikim me mjedisin. Temat përfshijnë procesin e liberalizimit dhe rinisë, shëndetësinë publike dhe dukuritë patologjike siç janë: alkoolizmi, droga, prostitucioni, huliganizmi etj. Në bazë të faktit që rinia është ardhmëria e shoqërisë - a kemi ne participim adekuat politik? Temat të cilat do të shtjellohen lidhen me problemet e tinxherëve, bashkëpunimin me shoqërinë, aktivizimin, jetën politike të rinisë, grupet e të rinjve-bandat, lëvizjet rinore, ndryshimet

shoqërore në shkollë, lagje etj.